



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UJËSJELLËS KANALIZIME PUSTEC SH.A
ASAMBLEJA E AKSIONAREVE

Nr. 338/3 prot.

Pustec, më 06.03.2023

V E N D I M

Nr. 3 datë 06.03.2023

PËR

MIRATIMIN E PRISHJES SË SHOQËRISË, E FILLIMIT TË PROCEDURËS SË
LIKUIDIMIT DHE EMËRIMIN E LIKUIDUESIT

Sot, më datë 06 Mars 2023, Shoqëria Ujësjellës Kanalizimeve Pustec Sh.A, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT L74004003B mbajti mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve. Mbledhja u thirr nga administratori i shoqërisë zoti Sandi Nikolla për të diskutuar **ndër të tjera , mbi çështjet e rendit të ditës si vijon:**

- Prishja e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizimeve Pustec Sh.A. dhe shpallja e saj në likuidim;
- Emërimi i Likuidatorit.

Në shqyrtim të çështjeve të mësipërme të rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve vëren:

Shoqëria Ujësjellës Kanalizimeve Pustec Sh.A. nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.5.2022 "Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe me Marrëveshjen noteriale të Transferimit të veprimtarisë ekonomike Nr. repertori: 5234, nr. koleksioni: 3522, datë 12.09.2022, të ndryshuar me Amendament kontratën noteriale datë 06.03.2023, të lidhur midis Shoqërisë Ujësjellës Kanalizimeve Pustec Sh.A. dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizimeve Korçë Sh.A., kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivitetet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 01.01.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbytur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijojë ekzistencën e saj dhe duhet të priset dhe të çregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

Pasi diskutoi gjerësisht mbi çështjet më sipër të rendit të ditës, Aksionari i Vetëm

V E N D O S I :

1. Përfundimin e aktivitetit të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizimeve Pustec Sh.A. dhe prishjen e saj.
2. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizimeve Pustec Sh.A shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese.
3. Emërimin e Z. Sandi Nikolla si likuidator të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizimeve Pustec Sh.A.
4. Likuidatori autorizohet të përgatisë Raportin Përfundimtar të Likuidimit të shoqërisë. Ai gjithashtu autorizohet të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likudimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likudimin e shoqërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E AKSIONAREVE TË UK PUSTEC SH.A

PALI KOLEFSKI

